



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Interreg - IPA CBC
Greece - Albania

Nr. 5005/1 Prot.

Berat, më 16/10/2020

SHPLLJE PËR POZICION TË LIRË PUNE

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore", ligjit nr 7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i azhurnuar, ligjin Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" Bashkia Berat kërkon të punësoj:

➤ ***një Inxhinier Mjedisi ose Biologji Mjedisore në kuadër të projektit E-Natura***

Financuar nga Programi IPA CBC Shqipëri-Greqi, Marrëveshja e Partneritetit nr.41, datë 07.01.2020, Marrëveshja Operacionle ndërmjet Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Bashkisë Berat nr.1226, datë 28.02.2020 për një periudhë 4 (katër) mujore (Nëntor 2020/Shkurt 2021).

Objektivi kryesor i projektit është zhvillimi agroturistik i dy rajoneve ndërkufitare, përmes ndërtimit të rrugicave të biçikletave dhe një parku veprimi. Nga një perspektivë mjedisore, të gjitha veprimet e planifikuara janë minimalisht invazive dhe të përshtatura për të promovuar dhe mbrojtur trashëgiminë natyrore të rajoneve të përfshira. Kontributi në rritjen e sektorit të biznesit turistik dhe përmirësimi i kapacitetit për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore.

Aktivitetet dhe objektet e orientuara drejt biçikletave kërkojnë menaxhim të qëndrueshëm mjedisor, pasi që vendet natyrore tërheqëse janë motivimi kryesor për ciklistat.

Zbatimi i koordinuar i strategjive dhe rezultateve të ofruara të projektit pritet të shkaktojë mundësi të shumta ekonomike dhe punësim në nivel rajonal.

Sipas parashikimit të buxhetit të Projektit për Bashkinë Berat, shuma totale e buxhetit është 94,000 euro, ku 85 % e shumës është grant i Bashkimit Europian dhe 15% është bashkëfinancim i Bashkisë Berat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Përshkrimi i Punës

1. Kandidati do të jetë përgjegjës për identifikimin dhe përcaktimin optimal të shtigjeve të eko-turizmit për bicikleta në gjithë terrenin e Bashkisë Berat , të cilat do të rrisin eksperiencat e turistëve dhe qytetareve.
2. Kandidati do të përgatisë termat e referencës së ndërhyrjeve të kërkuara për shtigjet e bicikletave, duke u bazuar edhe në Studimin Teknik të përgatitur nga Universiteti i Maqedonisë Perëndimore (Greqi), i cili është partneri koordinues.
3. Kandidati do të jetë përgjegjës për hartimin e studimit mjedisor për 4 shtigjet e bicikletave të cilat do të identifikohen për Bashkinë Berat.
4. Kandidati do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe miratimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shtigjet e bicikletave.
5. Kandidati do jetë përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike dhe projektit të zbatimit për shtigjet e bicikletave.
6. Kandidati do jetë përgjegjës për raportimin ditor dhe raportet mujore pranë Njesisë së Menaxhimit të Projektit në Bashkinë Berat mbi ecurinë e punës.
7. Kandidati do jetë përgjegjës për raportimin pranë partnerëve të Projektit në lidhje me përgatitjen e studimit teknik për Bashkinë Berat.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROÇEDURËN E PRANIMIT DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në proçedurën e pranimit janë:

- a) Të ketë shtetësi shqiptare
Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- b) Të jetë në kushte shendetësore që lejojnë të kryej detyrën përkatëse
- c) Të mos jetë e denuar penalisht me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale
- d) Master shkencor në fushën e mjedisit: biologji mjedisi, inxhinieri mjedisi
- e) Të jetë i pajisur me licensa; në ekspertizë dhe supervizim dhe testim mjedisor.
- f) Preferohet eksperiencia në projekte të ngjashme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Kandidatët duhet të plotësojnë kritere të veçanta si vijon:

- a) Të zotëroj Diplome Universitare / *Master shkencor* sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në “**Shkenca Natyrore**” si **inxhinieri mjedisi ose biologji mjedisor**. Si diploma Bachelor edhe ajo Master duhet të jenë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- g) Eksperienca në punë **5 (pesë) vite**, zbatimin dhe monitorimin e projekteve me ndikim mjedisor.
- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
- c) Njohja e gjuhës se huaj, Anglisht.

1.1 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Leter motivimi.
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Letër reference nga punëdhënësi i mëparshëm;
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore/ Dëshmi i gjëndjes gjyqësore (Dëshmi Penale)
- h- Çertifikate të njohjes së gjuhës së huaj
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë në sekretarinë e Bashkisë Berat, brenda datës **02.11.2020** Njoftimi do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Berat, në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Berat. Afati i ankimimit është **2 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit, do të njoftohen në e-mail-in e tyre:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista;



KRYETARI I BASHKISË

Ervin Demo